



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2023:231114
Datë: 24.05.2024
Numri i dokumentit: 05732351

Kom.Dh.Shk.II.nr.48/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së dytë, gjyqtarja Saranda Bogaj-Sheremeti, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit MitroVet Sh.P.K., me seli në Mitrovicë, rr. “Adem Voca”, kundër debitorit Komuna e Mitrovicës, rr. Bedri Gjinaj, me seli në Mitrovicë, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr.2010/22 të datës 29.09.2023, me datë 24.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pa themeltë ankesa e kreditorit MitroVet Sh.P.K., me seli në Mitrovicë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr.2010/22 të datës 29.09.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykatës Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.2010/22 të datës 29.09.2023, e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit Komuna e Mitrovicës, rr. Bedri Gjinaj, me seli në Mitrovicë, dhe e ka anuluar urdhrin përmbarimor P.nr.55/22, të datës 04.07.2022, të lejuar nga Përmbaruesi Privat Ilmi Miftaraj, me seli në Mitrovicë.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori MitroVet Sh.P.K., me seli në Mitrovicë, rr. “Adem Voca”, pa i përmendur shkaqet ankimore, me të cilën e ka kontestuar në tërësi aktvendimin e Gjykatës Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr.2010/22 të datës 29.09.2023, me propozim që të aprovohet si e bazuar ankesa e kreditorit, duke e lënë në fuqi Urdhrin për Përmbarim P.nr.55/22, të datës 04.07.2022 si dhe të anulohet aktvendimi KPPP.nr.2010/22 të datës 29.09.2023 i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë dhe të refuzohet prapësimi i debitorit.

Përgjigje në ankesa ka parashtruar debitori, duke kundërshtuar pretendimet e kreditorit dh ka propozuar që të refuzohet ankesa e kreditorit si e pa themeltë, dhe të vërtetohet aktvendimi i atakuar KPPP.nr.2010/22 të datës 29.09.2023 i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore (LPP), si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

- Ankesa e kreditorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori MitroVet Sh.P.K., me seli në Mitrovicë, rr. “Adem Voca”, me datën 04.07.2022 ka paraqitur propozim për lejimin e përmbarimit, kundër debitorit Komuna e Mitrovicës, rr. Bedri Gjinaj, me seli në Mitrovicë, në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturës për shumën e borxhit prej 7,485.00 €.

Përmbaruesi Privat Ilmi Miftaraj, me seli në Mitrovicë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit MitroVet Sh.P.K., me seli në Mitrovicë, ka caktuar urdhrin P.nr.55/22, të datës 04.07.2022, duke lejuar përmbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturës Nr.04/2022 të datës 15.04.2021, me të cilin e ka urdhëruar debitorin, që të ia paguaj kreditorit në emër të borxhit të përcaktuar sipas faturës shumën prej 7,485.00 €, me kamatë ligjore prej 8% si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore në pajtim me Udhëzimin Administrativ UA-MD Nr.06/2014, nën kërcënimin të përmbarimit të dhunshëm dhe pasojave tjera ligjore, përmbushja e detyrimit të realizohet përmes bllokimit të llogarive bankare të debitorit dhe transferimin e tyre në llogarinë e kreditorit, sekuestrimin e letrave me vlerë, sekuestrimi, vlerësimi shënimi i

përmbartimit në librin publik të paluajtshmërive, shitjen e sendeve dhe përmbushjen e detyrimit të kreditorit, të bëhet përmbartimi në pjesën e pasurisë së debitorit në shoqërinë tregtare, dorëzimi i sendeve të luajtshme dhe kreditori të fitoj të drejtën e pengun në sendet e luajtshme.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar KPPP.nr.2010/22 të datës 29.09.2023, e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit Komuna e Mitrovicës, rr. Bedri Gjinaj, me seli në Mitrovicë, dhe e ka anuluar urdhrin përmbartimor P.nr.55/22, të datës 04.07.2022, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Ilmi Miftaraj, me seli në Mitrovicë.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se në rastin konkret - Faturës Nr.04/2022 të datës 15.04.2021, në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbartim, nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së. Sipas vlerësimit të gjykatës së shkallës së parë dokumenti - Fatura, në bazë të së cilës është lejuar propozimi për përmbartim, nuk i plotësojnë kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se fatura në rastin konkret është lëshuar në mënyrë të një anëshme, pasi që nuk është pranuar nga debitori, për arsye se në faturë mungon nënshkrimi apo pranimi i debitorit apo përfaqësuesve të tij të autorizuar dhe nuk ka dëshmi se fatura është pranuar nga debitori. Andaj, duke qenë se debitori nuk e ka pranuar në mënyrë të rregullt faturën, si e tillë e njëjta nuk mund të shërbej si dokument i besueshëm dhe nuk ka tipare të përmbartueshmërisë.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë, e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë, në bazë të nenit 194 të LPK-së, i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore me rastin e vendosjes për aprovim të prapësimin të debitorit. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, Dhomat e Shkallës së Parë drejtë kanë vlerësuar gjendjen faktike kur kanë konstatuar se fatura e

lëshuara nga ana e kreditorit nuk përcakton detyrimi saktë dhe nuk përmbanë nënshkrimin nga debitori. Në këtë drejtim gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar kushtet ligjore nga Neni 29 par. 1 i LPP, i cili përcakton se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me paragrafin 3 të njëjtin nen përcakton se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se ne të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, kurse me nenin 37 të LPP-së përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*

Mbi bazën e kësaj dispozite ligjore, kjo Gjykatë vlerëson se dhomat e shkallës së parë kanë konstatuar drejtë se faturat si dokument i besueshëm mbi të cilën ishte iniciuar procedura përmbarimore, respektivisht është lejuar përmbarimi nuk i plotëson kushtet në mënyrë kumulative që duhet t’i ketë dokumenti i besueshëm. Në rastin konkret qartë rezulton se faturat nuk e përmbanë nënshkrimin e pranuesit, që është kusht esencial mbi bazën e së cilës dokumenti i besueshëm fiton tipare të përmbarueshmërisë së titullit ekzekutiv, mbi bazën e së cilës mund të konstatohet ekzistimi i detyrimit dhe pranimi si i tillë nga debitori. Së këndejmi, Gjykata thekson se pa plotësimin e këtyre kushteve dokumenti i besueshëm nuk mund ta ketë fuqinë e titullit përmbarues sepse rezulton se debitori nuk e ka pranuar detyrimin, prandaj dhe dokumentet e besueshme në raport me dokumentet tjera përmbarimore duhet ta kenë fuqinë e pa kontestuar ekzekutive në mënyrë që procedura përmbarimore të iniciohet përmes këtyre dokumenteve. Edhe prova tjetër e bashkëngjitur ndërkohë nga kreditori se përfaqësuesi i debitorit ka pranuar shkresën, nuk e validon pranimin e faturave përderisa ato nuk janë të nënshkruara nga përfaqësuesi i debitorit apo debitori.

Gjykata Komerciale - Dhomat e shkallës së dytë duke shqyrtuar pretendimet ankimore të kreditorit, vlerësojnë se janë tërësisht të paqëndrueshme pretendimet e kreditorit se të gjitha fatura i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm ashtu siç është paraparë me nenin 29 par. 1.3 të LPP-së, pasi që faturat janë dorëzuar rregullisht, janë të vulosura me çka vërtetohet se të njëjtat nuk janë kontestuar nga vet debitori. Pasi që në bazë të shkresave të lëndës shihet shumë kuart që asnjë nga fatura e paraqitura sipas urdhëri përmbarimor nuk është pranuar nga

debitori dhe mungon nënshkrimi i tij në të gjitha faturat e lartëcekura dhe nuk është përshkruar sak shuma e cila është detyrim për periudhën kohor për të cilën është lëshuar.

Së këndejmi, edhe gjykata e shkallës së dytë është e qëndrimit të njëjtë juridik se në procedurën përmbaremore organi përmbareues, përfshirë këtu edhe gjykatën që ka kompetencë shqyrtimin e ligjshmërisë së përmbaremit, nuk ka tagër të vlerësojë ligjshmërinë e raportit juridik nga i cili rrjedh dokumenti i besueshëm, statusin e palëve apo detyrimet e ndërsjella mes tyre. Por, organi përmbareues, përfshirë edhe gjykatën e shkallës së parë shqyrton vetëm rregullsinë dhe përshtatshmërinë e dokumentit përmbareues dhe/apo atij të besueshëm, me ç'rast procedura sipas prapësimit i nënshtrohet vetëm shqyrtimit formal të titullit ekzekutiv.

Andaj, duke marr parasysh pretendimet ankimore, të cilat konsistojnë ndaj aktvendimit të ankimuar, Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhoma e Shkallës së Dytë konsideron se këto pretendimet ankimore janë të pa bazuara, ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, dhe zbatimin të gabuar të drejtës materiale, të cilat shkelje kjo gjykatë i vështron sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe as të Ligjit të Procedurës Përmbaremore.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 209 pika b) të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhoma e shkallës së dytë
Kom.Dh.Shk.II.nr.48/24 dt. 24.05.2024

Gjyqtarja,

Saranda Bogaj-Sheremeti.

Numri i lëndës: 2023:231114
Datë: 24.05.2024
Numri i dokumentit: 05732351